

EDHE NJË GODITJE ËSHTË SHUMË

A ke qenë ti ose i afërmi juaj ndonjëherë objekt i dhunës fizike familjare? A je i shqetësuar, i zemëruar, ose i frikësuar? A po mendon se çfarë duhet të bësh dhe se kujt duhet t'i drejtohesh? A ke nevojë për ndihmë, mbështetje dhe këshilla praktike? A dëshironi të flisni për dhunën fizike me dikë që di të thotë ç'duhet bërë dhe që të dëgjon e kupton me zemër? Në rast se është kështu atëhere lexojeni këtë tekst me kujdes.

Çfarë është dhuna bashkëshortore?

Dhuna bashkëshortore mund të jetë keqtrajtim fizik – shtyrje, goditje dhe dhunë seksuale. Mund të jetë gjithashtu dhe ngacmim shpirtëror – sharje, abuzim, frikësim dhe kërcënim. Dhuna bashkëshortore mund të jetë edhe kur tjetrin e mbyll në shtëpi dhe e lë pa bukë e pa para si dhe e izolon nga kontaktet me botën e jashtme. Dhunë mund të jetë edhe shkatërrimi i pasurisë ose kërcënim me mjete financiare.

Fatkeqësisht dhuna është e përgjithshme. Fajtori më i zakonshëm në to është burri. Ai mund të jetë bashkëshorti ose shoku i viktimës, i dashuri, vëllai ose burrë beqar. Në shumicën e rasteve viktimja është gruaja: ajo mund të jetë bashkëshortja ose shoqja e ushtruesit të dhunës, e dashura, motra ose nëna e moshuar. Në raste të pakta ushtruesi i dhunës është grua.

Pasojat e dhunës mund të jenë traumatike për viktimën. Sa më tepër njeriu të vuajë nga dhuna aq më të mëdha janë edhe dëmet – keqardhje, dhimbje, angështi, pasiguri, pesimizëm, plogështi, urrejtje të fashitur, probleme të shëndetit mental, keqpërdorim të narkotikëve dhe kështu me radhë.

Megjithatë shpresa nuk humbet kurrë. Cikli i dhunës mund të tejkalohet. Shumë njerëz kanë arritur të shkëputen nga marrëdhënia e dhunëshme. Është arritur që ushtruesi i dhunës të marrë pjesë në programe kurimi, në të cilat ai/ajo ka shqyrtuar sjelljet e veta të dhunëshme dhe ka marrë vendimin për përfundimin e përdorimit të dhunës. Më pas është arritur një bazë më e shëndoshë dhe më sigurtë për vazhdimin e marrëdhënies.

Shpeshtësia e dhunës

Sipas një hulumtimit të publikuar në vitin 1998 nga qendra statistikore, 40 përqind e grave finlandeze kanë qenë objekte të dhunës fizike apo seksuale, ose objekti kërcënimimi me dhunë të ushtruar nga burri. Një nga pesta nga të intervistuarat ka treguar se ka qenë objekt i dhunës fizike brenda marrëdhënies bashkëshortore aktuale. Gjatë një viti para hulumtimit 90 000 gra kishin përjetuar dhunë fizike të ushtruar nga burri.

Dhuna në familje dëmton fëmijën

Dhuna që ushtrohet mbi nënën shton rrezikun që fëmija të jetë objekt i dhunës. Fëmija mund të përdoret edhe si instrument shtypje. Përjetimi i kontakteve të dhunëshme dëmton fëmijën. Ai mund të mbartë me vete plagë të shkaktuara nga të qarat e nënës, nga sjelljet e çorientuara dhe goditjet e babait. Janë pikërisht ata të cilët kanë provuar dhunë në shtëpi të cilët më vonë kthehen në të viktima ose ushtrues të keqtrajtimet. Por kështu nuk ka pse të ndodhë. Cikli mund të ndërpritet.

Asgjë nuk e justifikon dhunën

Për përdorimin e dhunës nuk ka justifikime. Kërcënimimi me ndarje, xhelozia, frika e braktisjes, neglizhimi seksual, fëmijëria e vështirë, situata ekonomike ose kushtet e vështira të banimit nuk mund të justifikojnë të goditjet me dorë. Edhe një goditje është shumë.

Dhuna është krim

Prokurori mund të ngrejë padi për aktin e dhunshëm që ka ndodhur brenda shtëpisë, edhe në qoftë se viktima nuk denoncon, ose nuk kërkon që ushtruesi i dhunës të dënohet. Keqtrajtimi që ndodh si në vende private ashtu dhe në ato publike është akt i dënueshëm me ligj. Denoncimi për aktin e dhunshëm duhet të bëhet në polici.

Ligji mbi ndalim-afrimin hyri në fuqi që në fillim të vitit 1999. Qëllimi i këtij ligji është të përmirësojë mundësitë për të ndërhyrë në rastet e shqetësimit të rëndë dhe të kërcënimit me mjete të dhunshme. Personi të cilit i jepet ndalim-afrimi nuk duhet të takojë as të kontaktojë personin në mbrojtje. Gjithashtu atij i ndalohet ndjekja dhe vëzhgimi i personit në mbrojtje. Ndalim-afrimi kërkohet nga policia ose direkt nga gjyqi komunal. Personit që ka ushtruar dhunë, ose ka kërcënuar me anë të mjeteve të dhunshme mund t'i ndalohet qëndrimi në një zonë të caktuar, psh në shtëpinë, ose në vendin e punës të personit në mbrojtje, si dhe në rrethinat përreth tyre. Informata të mëtejshme për ndalim-afrimin mund të gjeni te adresa internetore www.poliisi.fi

Kërkoni ndihmë

Dhuna nuk përfundon vetvetiu. Prandaj dhe viktima duhet të kërkojë vetë ndihmë. Ndonëse ushtruesi i dhunës nuk shfaqet ditë për ditë, prania e tij mund të ndihet vazhdimisht. Nëse nuk cikli i dhunës nuk këputet ai bëhet më i trashë dhe përsëritet gjithnjë e më shpesh.

Ndihmë i ofrohet si viktimave ashtu edhe ushtruesve të dhunës. Kontaktohu dhe bisedo me asistentë specialistë. Mund të mendoni së bashku se për çfarë lloj ndihme keni nevojë ti dhe i afërmi juaj. Siguria dhe qetësia në shtëpi janë gjërat më të rëndësishme. Secili ka të drejtë të jetojë një jetë pa dhunë.

Numrat e telefonave kombëtarë në rast nevoje:

Nurmi i përgjithshëm i urgjencës 112

Numri i urgjencës i policisë 10022

Numri i kujdestarisë për viktima 0600-16116

Numri i kujdestarisë për viktima – Këshilla juridike 0600-16117

Qendra për të përdhunuarat Tukinainen 0800-97899

Qendra për të përdhunuarat Tukinainen – Kujdestaria e juristëve 0800-97895

Linja e pamposhtur 6126 6 212

Qendrat Jussi dhe shtëpitë strehimore të bashkimit të shtëpive strehimore, informacion (09) 454 2440

Kujdestaria telefonike e grupeve kundër dhunës (Väkivallatomat ry) (09) 726 1600

Shoqata shumëkulturore Monika ry (09) 4114 8700

Qendra shëndetësore e komunës ku banoni, këshillimorja familjare, ose qendra këshillimore për çështje familjare

EDHE NJË GODITJE ËSHTË SHUMË!

Kjo broshurë gjendet në internet në adresën: www.vakivalta.net

Teksit u përgatit nga:

Projekti për parandalimin e dhunës kundër grave dhe prostitucionit

Stakes, PL 220, 00531 Helsinki

Tel. (09) 39 671, faks (09) 3967 2201